

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: Indeksonline SH.P.K.; INNOVATION MEDIA SH.P.K., Lidhja e Prizrenit, 10000, Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	05.12.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **05.12.2022**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **Indeksonline SH.P.K.; INNOVATION MEDIA SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-22-11551-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-051-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **Indeksonline SH.P.K.; INNOVATION MEDIA SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-22-11551-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-051-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **30.11.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-22-11551-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-051-2-2-1**.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: **Indeksonline SH.P.K.; INNOVATION MEDIA SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-22-11551-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-051-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **30.11.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **05.12.2022**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-ne me saktësisht me nenet NENI 7,28,59 dhe 60, duke rekomanduar eliminuar ofertën në kundërshtim me NENET e lartcekura për këto arsye:

AK ka shkelur NENIN 7, pasi që ka diskriminuar OE, përderisa oferta e jone është e përgjegjshme me çmimin me të lirë dhe është diskriminuar nga komisioni vlerësues i AK

AK ka shkelur NENIN 59, pasi që oferta e jone i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes dhe ka çmimin me të lirë pa TVSH, pasi që mediat janë të liruara nga TVSH-ja dhe si rrjedhojë vlera e ofertës duhet të mirëtohet çmimi pa TVSH,

AK ka shkelur NENIN 60, pasi që oferta e jone i ka plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit, është ofertë e përgjegjshme dhe ka ofertuar me çmimin të lirë pa TVSH dhe si e tillë do duhej të shpërblehej me kontratë.

AK ka vepruar në kundërshtim me sqarimin publik të KRPP-se

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkojë sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Kërkojmë nga AK, që të anulojë vendimin për rekomandim dhe lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe të veprojë në pajtim me LPP-ne dhe kriteret e dosjes së tenderit !?

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar,

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju informon se gjatë aplikimit të një procedure të prokurimit, *Çmimi i ofruar duhet të jetë konform të gjitha tatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës*

Në ofertën e juaj të dorëzuar, Formulari për Dorëzimin e Tenderit është me çmim të njëjte si te Përshkrimi i çmimeve (ku ju si Operator Ekonomik, keni dhënë çmim për çdo pozicion veçmas):

Oferta juaj – Përshkrimi i Çmimeve të dorëzuar nga ana juaj, shihe tabelarin:

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE: SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT					
Nr. Rend	Emri i projektit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Trans direkt i mbledhjeve te Asamblesë Komunale - Koha e rezervuar (1 – 3 ore); - Transmetimi direkt; - Incizimi i mbledhjeve të asamblesë komunale dhe ritransmetimi i tyre (si dhe arkiva për kuvendin komunal); - Transmetimi i Njoftimeve për mbledhjet e asamblesë Komunale (10 herë <u>mbrenda</u> ditës). Njoftimi duhet te behet 14 dite para datës se mbledhjes se asamblesë komunale.	Shërbime	24	195	4680
2	Video ngjarje me kërkesën e zyrës për marrëdhënie me publikun, videot do te realizohen ne Komune dhe gjithë territorin e Komunës së Rahovecit sipas nevojës se paraqitur	Shërbime	26	200	5200
TOTALI					9880

:

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 623-22-11551-2-2-1

Titulli i kontratës: **SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT**

Si përgjigje ndaj letres suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 SHËRBIMET E TRANSMETIMIT TË KUVENDIT DHE SHËRBIME TË TJERA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

3. Çmimi total i tenderit është:

9,880.00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Njoftimit për kontratë/dosjes e tenderit dhe Specifikave teknike.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit